

## **STATUT**

### **I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**"BRB Tech" Sh.p.k**

#### **KREU I:**

#### **ORTAKET- EMERTIMI- OBJEKTI- SELIA- KOHEZGJATJA**

Sot me date 22.10.2021, themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "BRB Tech" Shpk. Themelues i shoqerise BRB Tech Shpk eshte Z. Laurend Memelli, shtetas shqiptar, i datelindjes 30.09.1984, lindur ne Korçe dhe banues ne Tirane, me numer personal ID I40930057E, madhor, me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar; Ky Statut krijohet ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise nr. 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar dhe ligjin 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", te ndryshuar.

#### **Neni 1**

##### **Emertimi dhe Forma Ligjore**

1.1 Shoqeria tregtare eshte shoqeri vendase dhe emertoitet "BRB Tech" shpk, emertim i cili do te jete i stampuar dhe ne vulen e shoqerise.

1.2 Shoqeria eshte e formes me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k.), ne baze te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare". Shoqeria mund te shnderrohet ne nje forme tjeter me vendimin e Asamblese se Pergjithshme sipas parashikimeve ligjore te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

#### **Neni 2**

##### **Objekti i veprimitarise**

Veprimitari ne fushen e Teknologjise, mirembajtje e pajisjeve hardware dhe software, marketing online, krijimi i spoteve publicitare, krijimi dhe mirembajtja e faqeve te internetit dhe rrjeteve sociale.

#### **Neni 3**

##### **Selia e shoqerise**

Selia e shoqerise shoqerise eshte ne adresen: Rruga : Idriz Dollaku, Nd 51/1, Ap 28, Tirane.

Shoqeria ka te drejte te krijoje dege, filiale dhe/ose zyra perfaqesimi ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise ose jashte saj. Me vendim te Asamblese se Pergjithshme, mund te krijojen ose anullohen (ne rast se jane celur), seli, filiale, agjensi dhe perfaqesi si ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte saj. Njesite e tjera strukturore te shoqerise si dege apo perfaqesi dhe jashte shtetit krijojen kur nje gje te tille parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve

të huaja, normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

#### Neni 4

##### Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqërisë është e pakufizuar.

#### Neni 5

##### Kapitali

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 (njeqind) leke.

Lloji i kontributit eshte ne para ne vleren 100 (njeqind) leke, i ndare ne 1 kuote si me poshte:

Z. Laurend Memelli, eshte zoterues i 1 (nje) Kuote, qe i korrespondon 100 % (njeqind per qind) te Kapitalit te Shoqerise.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte nenshkruar dhe shlyer teresisht nga ortaku i shoqerise.

Ortaket kane pavaresi ligjore, organizative si dhe të drejta pronesie mbi cdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi cdo lloj pasurie tjeter të fituar ne rruge të ligjshme. Shoqeria pergiqjet vetem me kapitalin e saj.

#### Neni 6

##### Transferimi i kapitalit

6.1 Kuotat e kapitalit te Shoqerise e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- ç) dhurimit;
- d) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

6.2 Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

6.3 Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

#### Neni 7

##### E drejta e parablerjes

Transferimi për çdo arsy, tërësisht ose pjesërisht i pjesëve të kapitalit të Shoqërisë është subjekt i të drejtës së parablerjes në favor të ortakut tjeter, i cili mund të ushtrojnë këtë të drejtë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e njoftimit të dërguar me letër rekomande, i cili përban cmimin, bleresin e mundshem dhe menyren e pagimit.

Në rast se ortaku nuk përgjigjet brenda afatit të parashikuar, konsiderohet se ka hequr dorë prej të drejtës së parablerjes.

Ne rastin e mosushtimit te se drejtes se parablerjes nga ortaku, Ortaku qe do te shese kuotat duhet te njoftoje emrin e bleresit dhe kushtet te cilat nuk duhet te jene me te favorshme se sa ato te ofruara ortakut tjeter te shoqerise.

### **Organet e shoqerise**

Organi vendimmarres i shoqerise "BRB Tech" Shpk eshte Asambleja e Ortakeve e perbere nga ortaket e shoqerise. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zgjedhimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gi) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës. Të gjitha vendimet e marra nga ortaket regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

### **Neni 9**

#### **Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligji 9901, date 14.04.2008, nga ligje të tjera dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të ligjit per shoqerite tregtare.

Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në

mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

#### Neni 10

##### Mënyra e thirrjes

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### Neni 11

##### Kërkesa nga ortakët e pakicës

Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të ligjit per shoqerite tregtare.

Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kerkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kérkesën, ka të drejtë:

- a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përbushin kérkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
- b) t'i kérkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e nenit 14 te statutit.

Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrëthanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesat e tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar.

## Neni 12

### Përfaqësimi në asamble

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## Neni 13

### Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të Ligjit 9901, date 14.04.2008 , ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## Neni 14

### Marrja e vendimeve

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të ligjit nr. 9901, date 14.04.2008, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të ligjit per shoqerite tregtare, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

## Neni 15

### Procesverbalet e mbledhjes së asamblesë

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë



së përgjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

**Neni 16**  
**Administratori**

Shoqeria me perjegjesi te kufizuar administrohet nga një ose disa persona fizike. Administratori i shoqerise emerohet me vendim te ortakut te shoqerise. Afati i qendrimit ne detyre i administratorit te shoqerise eshte per një periudhe 5 (pese) vjecare. Administrator i kesaj shoqerie caktohet Z. Laurend Memelli.

Administratori i shoqerise i ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat, me perjashtim te kompetencave qe u njeh ligji shprehimisht Asamblese se Ortakeve ose te treteve. Administratoret kane perjegjesi ndaj shoqerise ose ndaj te treteve per shkeljet e ligjeve, statutit apo shkeljeve te kryera gjate administratimit. Administratori ne rastin konkret kryen dhe harton raportet financiare, llogarite vjetore etj.

**BILANCI, TË ARDHURAT DHE SHPERNDARJA E SHOQERISE**

**Neni 17**

Viti fiskal fillon ne 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor te cdo viti.

Per nxjerrjen e rezultatit kontabel të shoqerise, mbi bazen e aktivit dhe pasivit, ngarkohet nga Asambleja e Pergjithshme një ekspert kontabel i autorizuar.

**Neni 18**  
**Ekspertet kontabel te autorizuar**

Auditimi i brendshem i Shoqerise do te behet nga eksperte kontabel te autorizuar, te caktuar per një vit fiskal. Ekspertet kontabel te autorizuar emerohen nga Asambleja e Pergjithshme me vendim te zakonshem.

**Neni 19**

Nxjerra e rezultateve të Bilancit vjetor duhet bere me saktesi dhe duke respektuar të gjitha rregullat qe percaktohen ne Ligjin mbi Kontabilitetin dhe atyre të Sistemit të Taksave, qe jane të detyrueshme per t'u zbatuar nga cdo subjekt privat, qe ushtron veprimtari tregtare.

Kontabiliteti mbahet ne gjuhen Shqipe, ne monedhen Shqiptare dhe pasqyrohet ne librat perkates. Shoqeria mund te kete edhe llogari te vecanta ne valute. Shoqeria mund te marre financime nga ortaket, institucion finanziare qe operojne ne Shqiperi ose jashtë saj. Per kete qellim shoqeria mund te jape si garanci barre mbi pjeset e kapitalit ose sende te paluajtshme, me autorizim te Asamblese se Pergjithshme.

**Neni 20**

Bilanci Kontabel vjetor miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim nga ortaket, i cili jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve



ligjore sipas nevojave të zhvillimit të metejshem të shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecante etj.

#### Neni 21

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, mund te ndahen ndermjet ortakeve ne raport me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin e shoqerise.

Asamblea percakton pjesen qe iu takon ortakeve ne forme dividendesh.

#### Neni 22

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkaku, edhe para plotesimit të afatit per të cilën eshte krijuar sic mund të jene :

- a) me vendim te Asamblese se per gjithshme
- b) Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.
- c) me hapje e procedurave te falimentimit
- d) Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Pergjithshme merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoperi ne likuidim e siper".

#### Neni 23

Cdo mosmarreveshje apo konflikt qe mund të lind gjate ushtrimit të veprimtarise se Shoqerise si rregull dhe per gjithesht, ortaket duhet ta zgjidhin me mirekuptim, ne te kunderten kompetente per zgjidhjen e tyre jane Gjykatat Shqiptare.

#### Neni 24

Per cfare nuk eshte shprehur ne kete statut, do te rregullohet ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe udhezimet plotesuese dhe të ligjshme të dhena nga Asambleja e Pergjithshme.

#### Neni 25

Ky statut u redaktua ne 4 originale ne gjuhen shqipe me permbajtje dhe vlere te njejtë juridike.

### **ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

"BRB Tech" SHPK

Laurend Memelli

